



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:097252

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06285517

P.nr.669/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi në lëndën penale kundër të pandehurit G.R. për shkak të veprës penale: Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.476/18 e datës 27.08.2018, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 11.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë me numër PP.II.nr.476/18 e datës 27.08.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

G... R... nga i ati I..., e ëma S..., e gjinisë O..., i lindur me datë ... në D...,Komuna Glllogovc, me adresë të vendbanimit Rr. "...",nr...,Prishtinë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,me numër personal ..., me vendbanim të përkohshëm në S..., për veprën penale: Blerja,pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale që ka arritur në fillim të vitit 2024.

- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.476/18 e datës 27.08.2018 kundër të pandehurit G.R. për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Gjyqtarja e ka pranuar këtë lëndë më datë:02.09.2024 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas aktakuzës, i pandehuri është akuzuar se ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, për të cilën vepër është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit.

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim. Ndërkaq, sipas nenit neni 107 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 8 përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lart cekura konstaton se nga fillimi i vitit 2018 kur dyshohet se i pandehuri G.R. ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së për këtë vepër penale kanë kaluar gjashtë (6) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur në fillim të vitit 2024, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër për të cilën është akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPPK-së, si dhe neni 358 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore juridike, sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati, andaj gjykata për kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 1 dhe 8 të KPRK-së, e në mbështetje të nenit 358 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.669/2018, datë 11.10.2024

Gjyqtarja  
Dardane Ismaili

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.